

# Analiza e feces

Mostra e feçes duhet të merret direkt nga kafsha dhe jo nga toka, pasi aty egziston mundësia e përzierjes me kashtë ose jashtëqitje të vjetër.

## Çfarë tregon jashtëqitja për ushqyerjen?

Kur rendimenti i prodhimit në fermën e lopëve nuk i përmbush pritshmëritë, mund të bëhet një analizë e feçes për të plotësuar kontrollin e racioneve. Metoda e marrjes së feçes është shumë e rëndësishme!

Lopët e shëndetshme, të ushqyera me racione të përcaktuara mirë, nxjerrin me anë të jashtëqitjes kryesisht fibër, e cila ose është e vështirë për t'u shpërbërë ose nuk është e tretshme. Përveç kësaj, në feçe gjenden edhe lëndë ushqyese (kokra guri apo misri) të tepërta të cilat nuk janë tretur. Një përmbajtje e lartë e lëndëve ushqyese në feçe tregon një dietë të pabalancuar. Analiza e feçes mund të ndihmojë për të përcaktuar dhe përqindje të larta të proteinave, duke zbuluar kështu dhe mundësitë e kursimit. Tek kjo analizë i duhet kushtuar shumë rëndësi parametrave si përmbajtja e azotit, amidonit dhe fibrës.

Çfarë dhe sa ushqim ju japin kafshëve, bazohet nga eksperiencia, analizat e ushqimit dhe përlllogaritjet e racioneve. Sasia e ushqimit që hanë kafshët varet nga lloji dhe përbërja e komponentëve të ushqimit bazë, si dhe shija e tij. Se sa e tresin ushqimin kafshët, varet nga lloji dhe sasia e koncentratit, si dhe menaxhimi i grazhdave të ushqimit (sistemi i furnizimit me ushqim dhe shpeshtësia, koncentratit, etj).

## Mbledhja e mostrave është specifike

Mblidhni mostrën (feçen) nga kafshë të caktuara. Marrja e mostrës nga lopët të rastësishme, jep një informacion në përgjithshën në lidhje me gjendjen e ushqimit dhe të tretjes së të gjithë tufës. Feçja nga një kafshë e vetme e caktuar, ju ndihmon për të nxjerrë konkluzione për shkaqet e problemeve me ushqimin. Merrni me vete një lopatëz ose një kovë dhe nxiteni lopën të çohet në këmbë (p.sh. përdorni koncentrat si karrem). Përgatituni të veproni shpejt, pasi lopa lëshon jashtëqitje 60 deri në 90 sekonda pasi është ngritur në këmbë. Mblidhni feçen. Mos merrni mostër nga dyshemeja, pasi aty egziston mundësia e përzierjes me kashtë ose jashtëqitje të vjetër, gjë që redukton saktësinë e analizës.

Mbushni një qese plastike të fortë (rezistente ndaj çarjeve) me rreth 1 kg feçe, shtyni ajrin jashtë qeses dhe mbylleni atë mirë. Etiketojeni qesen në mënyrë të qartë me një marker rezistent ndaj ujit (p.sh. numri matrikullës, emri i lopës nëse ka). Më pas vendoseni qesen në ngrirje që të ndaloni procesin e fermentimit. Pasi mostra të ketë ngrirë plotësisht, mund ta dërgoni në një kuti kartoni me postë ose korrier. Sigurohuni me patjetër që nuk ka asnjë rrjedhje. Mostra mund të dërgohet edhe direkt në laborator. Çdo mostër duhet të ketë një letër shoqëruese, të cilën laboratorët zakonisht e vënë në dispozicion për t'a shkarkuar nga faqja e tyre e internetit. Letra shoqëruese, përveç të dhënave tuaja të kontaktit, përmban edhe informacione në lidhje me mostrën e feçes (lloji i kafshës) dhe parametrat e dëshiruar për të analizuar. Edhe sikur të përzgjidhen pak parametra, mund të zbulohen pika të dobëta në strukturimin e racioneve.

Kujdes: në një analizë feçesh në një laborator ushqimi, nuk kontrollohet automatikisht për viruse patogjene.